UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINË
Pranuar me: 20.06.2022
Nj. org. | Numër | Sasia | Vlera
01 | 3321 | 3 | –

# RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
# PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

| | |
|---|---|
| Fakulteti | i Filologjisë |
| Lëndët | Gjuhë angleze 1 (Bsc. Fizikë) Gjuhë angleze 2 (Bsc. Fizikë) Gjuhë angleze (Bsc. Kimi inxh) Gjuhë angleze (Bsc. Kimi) Gjuhë angleze1 (për biologë) Gjuhë angleze 2 (për biologë) Gjuhë e huaj (Bsc. Gjeografi) |
| | 1. Festa Shabani<br>2. Vjollca Belegu-Caka<br>3. Shpresa Veseli- Dragobuzhda<br>4. Besa Jerliu<br>5.Libron Kelmendi<br>6. Sarande Bublaku |

Komisioni vlerësues

| | |
|---|---|
| 1. Kryetar | Prof. Asoc. Dr. Sefer Avdiaj S. Avdiaj |
| 2. Anëtar | Dr. Sc. Blerta Mustafa B.Mustafa |
| 3. Anëtar | Dr. Sc. Lendita Kryeziu LKryez. |

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grada shkencore | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | | | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | | | Mosha (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Thirrja akademike | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë) | Nota Ba. | Nota Ma. | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë | | | | |
| 1 | Festa Shabani | MA | Jo | | | 8.97 | 8.80 | - | 27.11.1989 | 7 vite | Jo | **PO** |
| 2 | Vjollca Belegu- Caka | MA | Jo | | | 7.53 | 9.00 | - | 12.10.1963 | 5 vite | Jo | JO |
| 3 | Shpresa Veseli- Dragobuzhda | MA | Jo | | | 9.10 | 8.55 | - | 8.10. 1992 | 7 vite | Jo | JO |
| 4 | Besa Jerliu | MA | Jo | | | 7.84 | 9.29 | - | 5.10.1993 | 1 vit e tre muaj | Jo | JO |
| 5 | Libron Kelmendi | MA | Jo | | | 9.50 | 9.48 | - | 29.01.1996 | 1 vit | Jo | JO |
| 6 | Sarande Bublaku | MA | Jo | | | 9.84 | 9.73 | - | 11.06.1994 | 3 vjet e tetë muaj | Jo | JO |

**SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE**

**Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"**

**Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore**

**Për: Këshillin e Fakultetit të FSHMN-së**

Lënda: Raport dhe propozime të komisionit për vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në Konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime për vitin akademik 2022/23

Komisioni në përbërje: 1. Prof.asoc.dr. Sefer Avdiaj (kryesues), 2.Prof Ass. Dr. Blerta Mustafa dhe 3. Prof Ass. Dr Lendita Kryeziu, me Vendimin nr. Prot:3038, të datës 8.06.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkursin me nr, prot: 1/217, të datës 01.06.2022, shpallur nga UP-ja në uebfaqen zyrtare, si dhe duke u mbështetur në dispozitat Statutit të UP-së,

**Propozon**

Që për vitin akademik 2022/23, të angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime:

Në vijim e gjeni RAPORTIN e detajuar lidhur me të dhënat e kandidatëve të cilët kanë konkuruar dhe vendimin e komisionit:

**Propozohet:**

1. MA Festa Shabani: (lindur me: 27.11.1989), ka konkuruar për pozitën numër 23 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 8.97. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament më notën mesatare 8.80. E ka të miratuar tezën e doktoratës pas mbrojtjes së projektpropozimit në Universitetin e Prishtinës. Ka përvojë 7 vjeçare në mësimdhënie në arsimin e lartë, prej të cilave 6 në Universitetin e Prishtinës , përfshirë këtu edhe lëndët për të cilat kandidatja po aplikon. Sipas dëshmive të ofruara (vlerësimi i studentëve për të), kandidatja vlerësohet shumë lartë për profesionalizëm dhe përkushtim. Ajo gjithashtu ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare si dhe ato që lidhen me mësimdhënie siq është pjesëmarrja në katër konferenca të KETNET-it. Kandidatja në fjalë **propozohet** si bashkëpunëtore e jashtme për lëndët: Gjuhë angleze 1(Bsc. Fizikë) Gjuhë angleze 2( Bsc. Fizikë) Gjuhë angleze (Bsc. Kimi inxh) Gjuhë angleze (Bsc. Kimi) Gjuhë angleze1 (për biologë) Gjuhë angleze 2 (për biologë) Gjuhë e huaj (Bsc. Gjeografi)

2. MA. Vjollca Belegu-Caka, (lindur më: 12.10.1963), ka konkuruar për pozitën numër 22 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë -Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 7.53. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në po të njetin Universitet me notën mesatare 9.0. Është në përfundim të studimeve të doktoratës në Universietin e Evropës Juglindore. Kandidatja ka ofruar dëshmi se ka përvojë pune 5 vjeçare në Universitetine Prishtinës, përfshirë këtu edhe Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore. Edhe pse kandidatja në fjalë ka përgatitjen adekuate dhe përvojën e duhur në mësimdhënie në arsimin e lartë ajo ***nuk propozohet*** për bashkëpunëtore të jashtme, sepse ka notën mesatare në nivelin e studimit BA më të vogël se 8, që bie ndesh me pikën 3.2. të nenit 7 të rregullores nr. 1/95 me datë 24.06.2021.

3. MA. Shpresa Veseli Dragobuzhda (lindur më: 08.10.1992) ka konkuruar për pozitën numër 22 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 9.10. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament më notën mesatare 8.55 si dhe i ka të regjistruara studimet e doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturës dhe Komunikimit-programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Edhe pse kandidatja ka përvojë shtatë vjeçare në mësimdhënie në arsimin parauniversitar, ajo **nuk propozohet** për lektor të angazhuar sepse nuk ka përvojë të mësimdhënies në arsimin e lartë, në fushën përkatëse, e gjithashtu nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ndjekje të trajnimeve apo konferencave

4. MA. Besa Jerliu (lindur më:05.10.1993) ka konkuruar për pozitën numër 22 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë -Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 7.84. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master Universitetin e Evropës Juglindore me notën mesatare 9.29. Ka përvojë pune një vit e tre muaj në mësimdhënie në arsimin e lartë. Dëshmitë e përvojës së punës të ofruara nga kandidatja nuk janë konsistente me shënimet në CV. Kandidatja në fjalë ***nuk propozohet*** për bashkëpunëtore të jashtme, sepse ka notën mesatare në nivelin e studimit BA më të vogël se 8, që bie ndesh me pikën 3.2. të nenit 7 të rregullores nr. 1/95 me datë 24.06.2021 si dhe vendimi i nostrifikimit të diplomës është i pa noterizuar.

5. MA Libron Kelmendi (lindur më: 29.01.1996) ka konkuruar për pozitën numër 18 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 9.48. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në Universitetin e Evropës Juglindore me notën mesatare 9.50. Nuk ka ofruar asnjë dokument të trajnimeve për mësimdhënie dhe konferencave. Ka një vit përvojë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë. Kandidati në fjalë ***nuk propozohet*** për bashkëpunëtor të jashtëm, sepse ka përvojë më të shkurtër në fushën përkatëse sesa kandidatja e propozuar, kriter ky i përcaktuar sipas pikës 3.5. të nenit 7 të rregullores nr. 1/95 me datë 24.06.2021. Gjithashtu, në dokumentet e ofruara mungon noterizimi i nostrifikimit të diplomës.

6. MA. Sarandë Bublaku (lindur më: 11.06.1994) ka konkuruar për pozitën numër 22 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Edukimit, me notën mesatare 9.84. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në po të njëjtin Fakultet, më notën mesatare 9.73. Ka përvojë pune tri vjet e tetë muaj në mësimdhënie në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë. Ka ndjekur disa trajnime dhe konferenca në cilësi të pjesëmarrjes dhe jo prezantimit. Meqë, kandidatja është e profilizuar në fushën e edukimit, specifikisht në mësimdhënie dhe kurrikula, Komisioni **nuk e propozon** në pozitën e bashkëpunetorës së jashtme për pozitën në të cilën konkuron.

**Komisioni vlerësues:**

1. Kryetar — Prof. Asoc. Dr. Sefer Avdiaj
2. Anëtar — Dr. Sc. Blerta Mustafa
3. Anëtar — Dr. Sc. Lendita Kryeziu